



Në bazë të nenit 12, paragrafi 2, shkronja (d), lidhur me nenin 14, dhe 17, të Ligjit Nr-03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, publikuar në “Gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008”, e në mbështetje të nenit 19, paragrafi 3, pika 3.1 dhe 3.2 të Ligjit Nr-06/L-092, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, publikuar në “Gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës, Nr. 10/2019” e konform nenit 22, të Rregullores (QRK) Nr. 09/2020, për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës dhe neneve 15, 29, pika 2, të Statutit të Komunës së Suharekës, 01-Nr-8336, i datës 04.11.2008, Kuvendi i Komunës në Suharekë, në mbledhjen e mbajtur me datë, 30.08.2024, miraton këtë:

V E N D I M

Neni 1

Me këtë vendim firmës “**Design Lifts**” SH.P.K me seli në Rr. “Uran Ajeti” p.n, Matiçan Prishtinë me pronarë **Beqir KRASNIQI** me vendbanim të përhershëm në Rr. “Shaban Gashi” në fshatin Peçan Komuna e Suharekës; **I jepet** në shfrytëzim afatgjatë deri në **99, (nëntëdhjetë e nëntë)** vite prona e paluajtshme e Komunës, konkretisht parcela kadastrale **P-72116035-00151-0**, me sipërfaqe të përgjithshme prej: **3177m²**, sipas certifikatës së pronës Nr. 1433/2024 të datës 19.04.2024, zona kadastrale Reshtan, vendin i quajtur “**Grab**”, e evidentuar në emër të Komunës së Suharekës. Nga sipërfaqja e përgjithshme e cekur më lart ndahen për dhënien në shfrytëzim **2349m²**, me destinim sipas Hartës zonale të Komunës së Suharekës “Tregti/Afarizëm/Banim-ZSHP-2 dhe pjesërisht Infrastrukturë Rrugore”, sipas rekomandimit 01-Nr-016-49450 të datës 22.08.2024, të komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës.

Neni 2

Afati për shfrytëzimin e pronës së paluajtshme fillon të rrjedh nga data, **30.08.2024** dhe përfundon afati më datën, **29.08.2123**, pas mbarimit të këtij afati ose ndërprerjes së parakohshme të kontratës e drejta e shfrytëzimit i kthehet Komunës së Suharekës si titullar faktik dhe juridik i pronës së paluajtshme të cekur më lart.

Neni 3

3.1 Obligohet; Kryetari i Komunës që me personin juridik dhe fizik përfitues i përzgjedhur për shfrytëzimin e pronës së paluajtshme të Komunës, të lidh kontratë me të cilën i përcaktojnë të drejtat dhe obligimet e palëve kontraktuese.

3.2. Obligohet; përfituesi i pronës të paluajtshme të Komunës, konkretisht personi juridik dhe fizikë i cekur në neni 1, të këtij vendimi, që në afat prej 10, (dhjetë) dite nga data e miratimit të këtij vendimi të sjellin garancionin bankar ose sigurimin nga kompanitë e sigurimeve të licencuar në Republikën e Kosovës dhe atë 10% të vlerës së propozuar investive.

3.3 Nëse personat e cekur në paragrafin 2, të nenit 3, të këtij vendimi nuk e sjellin dokumentacionin e kërkuar në afatin ligjor, konsiderohet se ka hequr dorë nga shfrytëzimi i pronës së paluajtshme.

Neni 4

4.1 **Obliqohen** shfrytëzuesi i cekur në **nenin 1**, të këtij vendimi, që **pronën e paluajtshme** të cekur në nenin 1, të këtë vendim, ta shfrytëzon me mirëbesim si nikoqir i mirë, që mos t'ia humbë vlerën e saj.

4.2 Prona e paluajtshme në fjalë nuk e ndërron titullarin juridik, pronarë i saj mbetet Kuvendi Komunal i Suharekës dhe si e tillë ajo nuk mund t'i epet personit të tretë në shfrytëzim nga ana e shfrytëzuesit, nuk mund të tjetërsohet, nuk mund të jetë objekt i ndonjë barre tatimore apo çfarëdo ngarkese tjetër mbi këtë pronë.

Neni 5

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, ky vendim hyn në fuqi 15, ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81, të Ligjit Nr. 03/L-040 për vetëqeverisjen lokale, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008" dhe nenit 8, lidhur me nenin 9, të Rregullores, Nr. 10/2019, për procedurat e hartimit dhe publikimin e akteve të Komunave, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 të datës 23.10.2021 dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose web-faqen zyrtare të Komunës.

KUVENDI I KOMUNËSNË SUHAREKË

01-Nr-016-51841
Më datë 30.08.2024



Kryesuesi i Kuvendit

Mr. Bexhet KUÇI

